



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar-Maj, 2010

Qershor, 2010

TABELA E PËRMBAJTJES

TREGUESIT FISKALE KRYESORË PËR PERIUDHËN JANAR-MAJ 2010	2
Analiza e të ardhurave për periudhën janar-maj 2010	2
Vështrim i përgjithshëm	2
Të ardhurat sipas taksave dhe burimeve të tjera.....	3
Tatimi mbi vlerën e shtuar	3
Taksa doganore	4
Akciza.....	4
Tatimi mbi të ardhurat personale	5
Tatimi mi fitimin	6
Taksat nacionale	7
Të ardhurat nga pushteti vendor	7
Të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore	8
Analiza e shpenzimeve për periudhën janar-maj 2010	9
Vështrim i përgjithshëm	9
Shpenzimet korrente.....	10
Shpenzimet e personelit.....	11
Shpenzimet për interesa	12
Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes	12
Shpenzimet për subvensione.....	13
Shpenzimet për fonde speciale.....	13
Shpenzimet të pushtetit lokal.....	14
Pagesa e papunësisë	15
Ndihma ekonomike.....	15
Fondi rezervë i buxhetit të shtetit	15
Shpenzimet kapitale	18

TREGUESIT FISKALË KRYESORË PËR PERIUdhËN JANAR-MAJ 2010

Gjatë pesëmujorit të parë të 2010 të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 125.7 miliardë lekë (shih tabelen 1). Të ardhurat totale buxhetore ishin 4.4 përqind më të larta se e njëjta periudhe e një viti më parë. Në këtë periudhë, shpenzimet totale arritën në 137.3 miliardë leke (shih tabelen 1). Në linjë me politikën fiskale stabilizuese të Qeverisë, dhe në vijim të rishikimit (në Janar 2010) në ulje të shpenzimeve për 2010 kundrejt buxhetit (rishikim që do të finalizohet së shpejti me propozimin nga ekzekutivi të buxhetit suplementar në muajin korrik), shpenzimet në pesëmujorin e parë janë 2.5 përqind më të ulëta se në periudhën janar maj 2009, dhe 5.2 përqind më të ulëta se planifikimi në buxhetin fillestar. Ulja e shpenzimeve kundrejt pesëmujorit të parë të 2009 reflektohet më shumë në shpenzimet kapitale, që janë reduktuar me 30.3 përqind në bazë vjetore, ndërsa ato korente janë rritur me 7.4 përqind në bazë vjetore.

Deficit fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në 11.6 miliardë në pesëmujorin e parë të 2010, me rënie të ndjeshme kundrejt pesëmujorit të parë të 2009 (20.4 miliardë deficitit fiskal i një viti më parë). Për këtë periudhë, deficitit ishte planifikuar në 7.5 miliardë lekë. Deficitit është financuar në pjesën më të madhe me burime të brendshme (kryesisht huamarrje): 53 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e deficitit; 9.6 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brendshme neto. Financimi i huaj i deficitit të periudhës ka qenë në nivelin 1.9 miliardë lekë.

Miliardë lekë	Janar - Maj '09	Janar - Maj '10
TE ARDHURAT TOTALE	120.5	125.7
SHPENZIMET TOTALE	140.9	137.3
Nga të cilat: SHPENZIMET KORRENTE	103.9	111.6
Nga të cilat: SHPENZIMET KAPITALE	36.9	26.0
BILANCA FISKALE	-20.4	-11.6
BILANCI PRIMARE	-6.6	4.1

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUdhËN JANAR - MAJ 2010


Vështrim i përgjithshëm

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën pesëmujore arritën në 125.7 miliardë lekë, duke realizuar planin në masën 91 përqind dhe duke tejkaluar të ardhurat e një viti më parë me rreth 4.4 përqind. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 93 përqind ndaj parashikimit, ose rreth 85.3 miliardë lekë nga 91.5 miliardë lekë të planifikuara, me rritje vjetore 4.3 përqind; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 5.8 miliardë lekë nga 9.9 miliardë lekë të planifikuara dhe nga 6.1 miliardë lekë të një viti më parë; të ardhurat në fondet speciale arritën 22.4 miliardë lekë nga rreth 24.5 miliardë lekë të planifikuara, dhe kundrejt 21.8 miliardë të një viti më parë; te ardhurat nga ndihmat rezultojnë 1.4 miliardë lekë nga rreth 1.9 miliardë lekë të planifikuara; të ardhurat jo-tatimore kanë tejkaluar planin, duke qenë për këtë periudhe 10.8 miliardë lekë nga 9.6 miliardë lekë të planifikuara dhe 10.2 miliardë të një viti më parë.

Të ardhurat në dogana kanë patur ecuri të mirë gjatë pesëmujorit. Gjatë kësaj periudhe janë mbledhur në total 44.6 miliardë lekë, vetëm 143 milionë lekë më pak se parashikimi, si dhe 5.8 miliardë, ose 15.1 përqind më shumë se një vit më parë. Bazuar në të dhënat për pesëmujorin,

të ardhurat në dogana përbëjnë 52.2 përqind të të ardhurave gjithsej në tatime dhe dogana, dhe 39.3 përqind të të ardhurave tatimore.

Nga administrata tatimore janë mbledhur në total për periudhën Janar - Maj 40.8 miliardë lekë nga rreth 49.3 miliardë lekë të planifikuara. Të ardhurat në tatime kanë një rënie prej 5.4 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, ose 3.2 miliardë lekë. Në grafikun më poshtë janë paraqitur të ardhurat sipas kategorive, për periudhën Janar -Maj në vite.




Të ardhurat sipas taksave dhe burimeve të tjera

Tatimi mbi vlerën e shtuar

Të ardhurat totale nga TVSH-ja për periudhën Janar - Maj 2010 janë rreth 44.4 miliardë lekë nga 47.2 miliardë të planifikuara për periudhën, që do të thotë 2.8 miliardë lekë më pak, duke realizuar planin në masën 94 përqind. Krahasuar me pesëmujorin e parë të vitit 2009, të ardhurat nga TVSH-ja janë rritur me 4.7 përqind, ose 2 miliardë lekë më shumë.

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 32.5 miliardë lekë nga 32.6 miliardë lekë të parashikuara, duke realizuar planin e periudhës. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 72.3 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë 3.4 miliardë lekë më shumë ose 11.7 përqind. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara dhe çmimet në import) si dhe kursi i këmbimit të lekut me monedhat kryesore të tregtisë ndërkombëtare të Shqipërisë, Euro-s dhe Dollar-it. Sipas të dhënave të INSTAT për tregtinë e jashtme, importet në vlerë për pesëmujorin e parë të vitit 2010 janë rritur me 8.3 përqind, të ndikuara nga rritja e çmimeve në import për mallrat kryesore dhe nga efekti i kursit të këmbimit (mesatarisht leku është zhvlerësuar me 6.8 përqind kundrejt një viti më parë ndaj Euro-s dhe 4.3 përqind ndaj Dollar-it). Rritjen vjetore më të lartë në vlerë për pesëmujorin e kanë patur importet e këryre artikujve: minerale, lëndë djegëse; ushqime, pije, duhan; prodhime druri dhe letre; tekstile dhe këpucë, materiale ndërtimi dhe metale, ndërsa në ulje vazhdojnë të jenë gjatë këtij viti importet e makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi.

Nga administrata tatimore për periudhën Janar - Maj janë mbledhur 11.9 miliardë lekë nga 14.6 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë 18.7 përqind më pak. Të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 27.7 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime janë ulur me 1.4 miliardë lekë, ose 10.5 përqind. Në grafikun më poshte paraqiten të ardhurat nga TVSH-ja për pesëmuorin e parë në vite.



Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar - Maj janë rreth 2.6 miliardë lekë nga 3 miliardë lekë të planifikuara, duke realizuar 88 përqind të planit; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 366 miliardë lekë, ose 12.3 përqind. Niveli mesatar i taksës doganore për këtë periudhë është 2.1 përqind, ndërsa një vit më parë ishte 2.5 përqind. Lidhur me tarifat preferenciale, gjatë këtij viti po zbatohen reduktimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA), me Turqinë dhe me vendet e Bashkimit Europian.

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar - Maj arritën në rreth 14 miliardë lekë nga 14.8 miliardë lekë të planifikuara, duke realizuar planin në një masë të kënaqshme me 95 përqind. Të ardhurat nga akciza kanë pësuar rritje të konsiderueshme prej 14.6 përqind në krahasim me të njëjtën periudhë të një vit më parë, ose 1.8 miliardë lekë më shumë.

Nga administrata doganore janë mbledhur rreth 8.6 miliardë lekë nga 9.2 miliardë lekë të planifikuara për periudhën Janar - Maj, me një mosrealizim të parashikimit prej 6.1 përqind. Të ardhurat nga Akciza që ka mbledhur dogana përbëjnë 60.9 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza dhe ecuria e tyre ka qënë vendimtare në realizimin e këtij zëri në buxhet. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birres së importuar, si dhe të mallrave të tjerë (me peshë më të vogël) që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës. Në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit 2009, të ardhurat nga akciza në doganë janë plot 2 miliardë lekë më shumë, ose rreth 30 përqind. Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata është si vijon: sasia e karburanteve të zhdoganuar për periudhën Janar - Maj 2010 është 172.9 mije ton, me

rritje 8.3 përqind; sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar - Maj 2010 është 1.4 mijë ton, me një rritje prej rreth 9.1 përqind; sasia e kafes të zhdoganuar për periudhën Janar - Maj 2010 është 2.1 mijë ton, me rënie prej rreth 24.8 përqind; sasia e berrës së zhdoganuar për periudhën Janar - Maj 2010 është 10.7 milionë litra, me një rënie prej 9.3 përqind.

Nga administrata tatimore akciza është mbledhur në masën 96 përqind të planifikimit, ose 5.4 miliardë nga 5.6 miliardë lekë të planifikuara. Të ardhurat nga akciza të mbledhura nga tatimet përbëjnë rreth 39.1 përqind të të ardhurave gjithsej nga akciza. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga akciza në tatime janë 4 përqind më të ulëta. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike përveç berrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO).

Të ardhura, miliardë lekë	5 mujor 2009	5 mujor 2010
Akciza mbi cigaret	3.3	4.0
Akciza karburant importi	5.8	7.8
Akciza karburant vendi	2.1	1.2
Akciza pije alkoolike import	0.5	0.4
Akciza pije alkoolike vëndi	0.2	0.2
Të tjera	0.3	0.3

Në shtator të 2009 norma e akcizës mbi disa mallra u rrit: për kafen rritja ishte rreth 40 përqind; për pijet alkoolike (me forcë alkoolike ndaj volumit mbi dhe nën 12 përqind) rreth 50 përqind; për cigaret rreth 27 përqind. Edhe pse pjesërisht të kundër-balancuara nga ulja e importeve, këto rritje ndikuan në nivelin e të ardhurave të mbledhura për periudhën, krahasuar me një vit më parë. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të ardhurat nga akciza për pesëmujorin e parë në vite.



Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 10.4 miliardë lekë nga 11.8 miliardë lekë të planifikuara, pra rreth 11.7 përqind nën parashikimin për periudhën. Krahasuar me të

njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto të ardhura janë ulur me 0.8 përqind. Nga evidencat paraprake të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që i referohen katermujorit të parë të vitit 2010 rezulton se: në total ka një rënie të numrit mesatar mujor të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 0.8 përqind kundrejt katërmujorit të parë të 2009. Për sektorin privat rënia e numrit të të punësuarve (mesatarisht në muaj) është prej 0.5 përqind (katërmujor 2010 kundrejt katërmujor 2009). Megjithatë, brenda kësaj shifre, *subjektet me TVSH kanë një rritje të kontribuesve prej 4.5 përqind* ndërsa subjektet e biznesit të vogël një ulje prej 8.8 përqind. Numri mesatar mujor i të punësuarve në sektorin publik (buxhetorë dhe ndërmarrje shtetërore) rezulton i reduktuar me 2.7 përqind.

Sipas sektorëve të ekonomisë, janë ulur të punësuarit në prodhim (-1.7 përqind), ndërtim (-4.8 përqind), transport (-5.2 përqind), ndërsa me rritje janë tregtia dhe shërbimet, përkatësisht me +0.45 përqind dhe +0.2 përqind.


Të ardhurat nga tatimi mbi pagën e të punësuarve të sektorit publik kanë qenë rreth 3.4 miliardë nga 3.2 të vitit të kaluar me një rritje prej 7.1 përqind; të ardhurat nga tatimi mbi pagën në sektorin jopublik kanë qenë 3.3 miliardë lekë nga 2.8 miliardë të një viti më parë, me rritje prej 15.1 përqind.

Të ardhura, miliardë lekë	5 mujor 2009	5 mujor 2010
Paga sektori publik	3.2	3.4
Paga sektori jo publik	2.8	3.3
Interesa	1.2	1.2
Dividendë	0.3	0.2
Shitje pasuri e paluajtshme	0.9	1.0
Të tjera	2.1	1.3

Në uljen e nivelit të të ardhurave të mbledhura nga TAP-i krahasuar me vitin 2009 ka ndikuar dhe zëri i të ardhurave të mbledhura mbi çmimin e shitjes në privatizimet e kompanive shtetërore (në masën 10 përqind). Gjatë vitit 2009 të ardhurat nga privatizimi ishin shumë më të larta se gjatë vitit në vijim.

Tatimi mbi fitimin

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për pesëmujorin e parë të vitit 2010 arritën në rreth 7.5 miliardë lekë nga 8.2 miliard të planifikuara, duke qenë në nivelin 91 përqind ndaj parashikimit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë të ardhurat nga kjo taksë kanë pësuar një ulje prej 701 milionë lekë, ose 8.6 përqind. Tatimi mbi fitimin e kompanive parapaguhet në bazë të fitimeve të realizuara gjatë periudhave të mëparshme të aktivitetit të tyre. Gjatë vitit 2009, fitimet e kompanive pësuan rënie dhe situata financiare e tyre u veshtirësua. Kjo ka ndikuar në uljen e kësteve të parapagimit të tatim fitimit për vitin 2010 dhe do të ndikojë në të ardhurat e mbledhura nga ky zë për gjithë vitin 2010. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga tatim fitimi dhe tatimi mbi të ardhurat personale për katërmujorin e parë në vite.




Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale janë 6.4 miliardë lekë nga 6.7 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Maj, ose 96 përqind të parashikimit. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 864 milionë lekësh, ose 15.5 përqind. Në grupin e taksave nacionale, zërat më të rëndësishem janë taksa e qarkullimit rrugor, renta minerare dhe taksa mbi importin e automjeteve të përdorura (e cila u ndryshua sëfundmi, me efekte nga muaji korrik 2010). Për pesëmujorin, 1.9 miliardë lekë janë mbledhur nga taksa e qarkullimit rrugor, ose 6 përqind më pak se një vit më parë; të ardhurat nga renta kanë rritje vjetore 23 përqind (gjithsej 970 milionë lekë për 2010, kundrejt 789 milionë të një viti më parë); të ardhurat nga taksa mbi importin e makinave të përdorura për periudhën pesëmujore janë 1 miliardë lekë, ose 12.7 përqind më pak se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Të ardhurat nga pushteti vendor


Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar - Maj arritën në 5.8 miliardë lekë nga 9.9 miliardë lekë të planifikuara, duke realizuar vetëm 58 përqind të planit, ndërsa kundrejt pesëmujorit të parë të vitit 2009 të ardhurat janë ulur me 347 milionë lekë (rreth 5.7 përqind). Nga taksat vendore mbi biznesin e vogël janë mbledhur rreth 1.4 miliardë lekë, nga 2 miliardë lekë të planifikuara, duke qëndruar në të njëjtin nivel me të ardhurat e mbledhura gjatë pesëmujorit të parë të vitit 2009. Nga taksat mbi pasurinë, ku hyjnë taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore, të cilat përbëjnë 18 përqind të të ardhurave nga pushteti vendor gjithsej, janë mbledhur këtë periudhë 985 milionë lekë nga 2.6 miliardë të parashikuara dhe 189 milionë, ose 23.8 përqind më shumë se një vit më parë. Taksat e tjera vendore kanë mbledhur rreth 3.3 miliardë lekë nga 5.2 të parashikuara, dhe 14 përqind më pak se vitin e kaluar. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga taksat vendore për pesëmujorin e parë në vite.



Të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore

Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën Janar - Maj 2010 arritën në 22.4 miliardë lekë nga rreth 24.5 miliardë lekë të planifikuara, duke realizuar planin e periudhës në masën 91.5 përqind, me një rritje prej vetëm 2.9 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për periudhën Janar - Maj. Gjatë muajit Maj janë regjistruar dhe hyrjet e para në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, në një vlerë prej 552 milionë lekë, kundrejt planit të pesëmujorit prej 450 milionë lekë.


Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 18.9 miliardë lekë (11.9 përqind më pak se parashikimi), si dhe 3.1 përqind më pak se e njëjta periudhë e vitit të kaluar; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 3 miliardë lekë (14 përqind më shumë se plani i periudhës) si dhe 29.3 përqind më shumë se pesëmujori i një viti më parë. Në grafikun më poshtë paraqiten të ardhurat nga fondet speciale për pesëmujorin e parë në vite.



ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR - PRILL 2010

Vështrim i përgjithshëm

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit Maj 2010, arritën në rreth 137.3 miliardë lekë, nga rreth 144.9 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 94.8 përqind të parashikimit të periudhës, ose me një mosrealizim prej rreth 7.6 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 33.4 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 3.6 miliardë lekë më pak, ose rreth 2.5 përqind më të ulëta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute, ritmi i rritjes së tyre gjatë pesëmuajoreve të parë, në disa vite, si dhe ritmi linear i rritjes, jepet në grafikun e mëposhtëm:




Shpenzimet e përgjithshme sipas elementeve kryesore përbërës të tyre, realizuar gjatë periudhës Janar - Maj të viteve 2000 - 2010 (në milionë lekë), jepen në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIMET NE VITE 5-MUJORI I PARE

ne milion leke


	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
TOTALI I SHPENZIMEVE	57,235	64,524	66,684	72,128	76,898	83,010	76,322	86,499	105,683	140,885	137,311
I. Shpenzime Korrente	48,348	53,265	57,717	63,520	68,385	73,304	69,954	76,958	87,291	103,916	111,626
1 Personeli	12,530	15,100	15,381	16,756	18,290	20,344	20,585	21,058	24,700	24,299	26,642
2 Interesat	12,016	10,389	10,241	12,622	13,030	11,052	10,072	10,067	12,359	13,816	15,679
3 Shpenzime Operative Mirembajtje	6,301	5,456	6,760	7,976	8,116	8,738	6,390	7,857	7,856	10,793	10,784
4 Subveconet	1,196	3,273	3,823	1,596	1,627	1,367	838	926	700	1,069	522
5 Shpenzime per Sig.Sociale	11,670	13,627	15,243	17,124	19,172	21,240	22,864	26,555	28,624	36,615	40,141
6 Buxheti lokal	1,425	2,160	3,156	4,411	4,642	6,436	5,361	6,253	8,222	11,402	10,959
7 Shpenzime te tjera	3,210	3,260	3,113	3,035	3,508	4,127	3,844	4,242	4,830	5,922	6,899
II. Shpenzime Kapitale	8,468	11,067	8,967	8,608	8,513	9,706	6,368	9,541	16,984	36,885	25,685
1 Financimi Brendshem	4,139	5,578	4,409	4,555	4,465	5,455	4,221	7,431	8,262	32,853	20,838
2 Financimi Huaj	4,329	5,489	4,558	4,053	4,048	4,251	2,147	2,110	8,722	4,032	4,847

Në totalin e shpenzimeve buxhetore të realizuara, gjatë pesëmuajorit të parë të vitit 2010, shpenzimet korrente regjistruan vlerën prej rreth 81.3 përqind, nga rreth 81.7 përqind të parashikuara, ndërkohë që shpenzimet për investime regjistruan vlerën 18.7 përqind nga 17.7 përqind të parashikuara. Një vit më parë struktura e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të shtetit të realizuara gjatë periudhës Janar - Maj, ishte rreth 73.8 përqind shpenzimet korrente dhe rreth 26.2 përqind shpenzimet kapitale.



Shpenzimet korrente

Në fund të muajit Maj 2010, kanë arritur në rreth 111.6 miliardë lekë, ose rreth 94.3 përqind të parashikimit të periudhës, duke rezultuar me një mosrealizim prej rreth 6.8 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 35.0 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 7.7 miliardë lekë më të larta, ose rreth 7.4 përqind më shumë.




Sipas zërave përbërës të shpenzimeve korrente, situata e realizimit të tyre në fund të muajit Maj 2010, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:


	Shpenzimet korente	Parashikimi janar-maj 2010 ne mln leke	Realizimi janar-maj 2010		
			Ne milion leke	Ne %	Struktura ne %
1	Shpenzime personeli	25654	26642	103.9	23.9
2	Interesa	17070	15679	91.9	14.0
3	Shpenz oper, mirembajtjes	12079	10784	89.3	9.7
4	Subvensionet	638	522	81.9	0.4
5	Shpenzimet per fonde speciale	43148	40142	93.0	36.0
6	Shpenzimet buxh vendore	12363	10959	88.7	9.8
7	Shpenzime te tjera	7458	6899	92.5	6.2
8	Kompensimi i pronareve				
	Totali i shpenz korente	118410	111627	94.3	100.0

Shpenzimet e personelit

Brënda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 23.9 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës Janar - Maj 2010, rezultojnë me një tejkalim prej rreth 1.0 miliardë lekë, ose rreth 3.9 përqind më shumë se parashikimi i periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit Maj janë realizuar në rreth 39.4 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultuan rreth 2.3 miliardë leke më të larta, ose rreth 9.6 përqind më shumë.




Tejkalimi në shpenzimet e personelit është rrjedhojë e tejkalimit në zërin paga dhe shpenzime për kontribute për sigurimet shoqërore, respektivisht për rreth 881 milionë lekë dhe 107 milionë lekë. Shpenzimet për pagat janë në të njëjtën kohë rreth 2.8 miliardë lekë më të larta se një vit më parë, ose rreth 13.9 përqind më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 454 milionë lekë më pak, ose rreth 11.0 përqind më të ulëta, se një vit më parë.



Shpenzimet për interesa


Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 14.0 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës Janar - Maj 2010, rezultojnë me një kursim prej rreth 1.4 miliardë lekë, si rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 507 milionë lekë në interesat e brëndeshme dhe rreth 884 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 36.0 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 1.9 miliardë lekë më të larta, ose rreth 13.5 përqind më shumë. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë pesë muajve të parë, në vite jepet nga grafiku i mëposhtëm:



Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes


Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës Janar - Maj 2010 regjistruan vlerën prej rreth 10.8 miliardë lekë duke shënuar rreth 1.3 miliardë lekë nën nivelet e parashikuara.

Kundrejt planit vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 28.9 përqind të tij. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë pothuajse në nivelet e realizimit të vitit të kaluar.



Shpenzimet për subvencione


Shpenzimet për subvencione në fund të muajit Maj 2010 regjistruan vlerën prej rreth 522 milionë lekë, ose rreth 116 milionë lekë më pak se parashikimi. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në nivelin 27.0 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 51.2 përqind më të ulëta, ose rreth 547 milionë lekë më pak.



Shpenzimet për fonde speciale


Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës Janar - Maj 2010 rezultojnë me rreth 3.0 miliardë lekë më pak, apo rreth 7.0 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kjo situatë është rrjedhojë e mosrealizimit prej rreth 2.2 miliardë lekë të shpenzimeve për sigurimet shoqërore dhe rreth 273 milionë lekë të shpenzimeve për sigurimet shëndetësore dhe rreth 550 milionë lekë në shpenzimet për kompensimin e ish pronareve. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 36.4 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 38.3 përqind të planit vjetor dhe sigurimet shëndetësore janë realizuar në rreth 37.4 përqind të këtij plani.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë me rreth 2.5 miliardë lekë më shumë, ose rreth 8.8 përqind më shumë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 1.1 miliardë lekë më të larta, ose rreth 12.3 përqind më shumë.



Shpenzime të pushtetit lokal

Shpenzimet e pushtetit lokal regjistrojnë një vlerë prej rreth 8.0 përqind të shpenzimeve buxhetore në total. Për periudhën Janar - Maj, 2010 ato kanë arritur në rreth 11.0 miliardë lekë, nga rreth 12.4 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2010, duke rezultuar me një mosrealizim prej rreth 1.4 miliardë lekë, ose rreth 11.4 përqind më pak se plani i periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 28.7 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 443 milionë lekë më të ulëta, ose rreth 3.9 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit lokal për periudhën Janar - Maj për disa vite, paraqitet nëpërmjet grafiku të mëposhtëm.



Shpenzimet korrente të kryera nga pushteti lokal, në fund të muajit Maj 2010, kanë arritur në rreth 7.9 miliardë lekë dhe regjistruan 71.6 përqind të shpenzimeve të kryera në total. Rreth 46.4 përqind, ose 3.6 miliardë lekë nga këto janë shpenzime për pagat e personelit, 0.07 përqind, ose 0.6 miliardë lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit, 46.1 përqind, ose 3.7 miliardë lekë shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes.


Shpenzimet për investime të kryera nga pushteti lokal, rezultojnë në vlerën 3.1 miliardë lekë dhe regjistruan një vlerë prej rreth 28.4 përqind të totalit të shpenzimeve të kryera në këtë periudhë. Rreth 99.5 përqind, ose 3,14 miliardë lekë janë shpenzime për investime të kryera me financim të brëndshëm dhe vetëm 0.5 përqind, ose 0.017 miliardë lekë janë kryer me financim të huaj.

Pagesa e papunësisë

Pagesa e papunësisë rezulton në rreth 9.5 përqind të parashikimit të periudhës, duke regjistruar rreth 14.3 përqind më shumë se një vit më parë dhe në të njëjtën kohë rreth 46.1 përqind të parashikimit vjetor.

Ndihma ekonomike

Ndihma ekonomike gjatë periudhës Janar - Maj 2010 rezulton rreth 45 milionë lekë më pak, ose rreth 0.7 përqind nën parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 39.0 përqind e planit vjetor.



Fondi rezervë i buxhetit të shtetit

Deri në fund të muajit Maj të vitit 2010, fondi rezervë i buxhetit të shtetit, është prekur nëpërmjet 39 vendimeve të Këshillit të Ministrave, në shumën 1.2 miliardë lekë, nga 2.5 miliardë lekë të planifikuar për t'u përdorur, ose rreth 47.5 përqind e tij.

(Në milionë lekë)


	Parashiku ar per vitin 2010	Perdorur me vendime te KM deri ne fund te majit	Ekzekutuar	Perqindja (Perdorur/parashiku)	Perqindja (Ekzekutuar/parashiku)
Fondi Rezerve	2500.0	1186.7	1134.7	47.5	45.4

Nga 39 vendime të Këshillit të Ministrave të miratuar për përdorimin e fondit rezervë deri në fund të muajit Maj 2010, dy vendime, me vlerë totale prej rreth 52 milionë lekë, nuk ishin ekzekutuar dhe si rrjedhojë e këtij fakti, vlera e fondit rezerve të Këshillit të Ministrave, e papërdorur deri në fund të muajit Maj, ishte rreth 1.4 miliardë lekë.

Nga fondi i ekzekutuar, prej rreth 1 134.7 milionë lekë, rreth 1.87 përqind është përdorur për shpenzime personeli, rreth 54.27 përqind për shpenzime të tjera korrente dhe 43.86 përqind për investime, siç duket edhe nga tabela dhe grafiku i mëposhtëm.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, sipas zërave të shpenzimeve:

		Fondi rezervë i ekzekutuar	
		Në milionë lekë	Në përqindje
1.	Shpenzime personeli	21.3	1.9
	-Shpenzime per paga	18.4	1.6
	-Shpenzime per sig.	2.9	0.3
2.	Shpenzime te tjera korente	615.8	54.3
	-Shpenz operativ+mirembajtjen	282.5	24.9
	-Subvensionet	0.0	0.0
	-Transfertat e brendeshme	264.7	23.3
	-Transfertat e jashtme	68.5	6.0
	-Transfertat tek familjaret/individ.	0.1	0.0
3.	Investime	497.7	43.9
	-Te patrupezuara	9.7	0.9
	-Te trupezuara	487.9	43.0
	TOTALI	1134.7	100.0



Rreth 25.8 përqind e fondit rezervë, ose rreth 306.4 milionë leke i janë dhënë Ministrisë së Brëndshme, nga të cilat përmendim fondet për emergjencat civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmytjet natyrore; fondet për dëmet e shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e tërmetit, në Qarkun e Dibrës; fondet për komunën Paskuqan të qarkut të Tiranës, për zbatimin e projektit emergjent "Rreshqitja e varrezave në Paskuqan, për marrjen e masave rehabilituese dhe mbrojtëse"; fondet për zbatimin e projektit "Rehabilitimi i mbulesave të pallateve në lagjen nr.1, Kukës"; fondet për Bashkinë Krujë, të qarkut të Durrësit, për zbatimin e projekteve emergjente, që lidhen me marrjen e masave rehabilituese dhe mbrojtëse nga fatkeqësi të ndryshme; për dhënie ndihme financiare familjes së Z.Gjetan Pjetër Lala, të cilës i është dëmtuar banesa nga fatkeqësitë natyrore; për dhënie ndihme financiare familjes së Z.Artur Kaja, të cilit i janë shkaktuar dy viktima dhe tre të plagosur rëndë nga zjarri i rënë në banesë, më datë 22.11.2009; për realizimin e një spoti publicitar për informimin e shtetasve shqiptarë në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave.

Rreth 244 milionë lekë, ose rreth 20.6 përqind i është akorduar Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve, për ndërhyrjet emergjente në objektet e mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve dhe për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Për Kryeministrinë është përdorur rreth 15.1 përqind e këtij fondi, ose rreth 179.1 milionë lekë, për pagesën e zyrës së PNUD-it, si dhe për dy shtesa në buxhetin e saj.

Rreth 55.4 milionë lekë, ose 4.7 përqind e këtij fondi është përdorur për dhënie ndihme financiare qeverisë së Kosovës, për realizimin e projekteve të propozuara për komunën Gracanice, Kosovë.

Rreth 52.3 milionë lekë, ose rreth 4.4 përqind e fondit rezervë është përdorur për një shtesë në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Drejtësisë, për mbulimin e shpenzimeve të qirasë së zyrave të misionit EURALIUS.

Në sektorin e shëndetësisë, është akorduar rreth 42.8 milionë lekë, ose rreth 3.6 përqind e totalit të fondit rezerve të Këshillit të Ministrave. Ky fond ka shërbyer kryesisht për të përballuar shpenzimet, të cilat lidhen me kurimin e personaliteteve dhe njerëzve, që kanë patur nevojë për kurim jashtë vëndit dhe për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e implantimit koklear, për disa fëmijë.


Rreth 140.7 milionë lekë, ose rreth 11.9 përqind e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, i janë akorduar Ministrisë së Financave, për kryerjen e rikonstruksionit të Akademisë së Trajnimeve të Administratës Tatimore dhe Doganore, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë më të plotë të përdorimit të këtij fondi, sipas institucioneve për periudhën Janar - Maj 2010.

Përdorimi i Fondit Rezervë	Nr. vendimesh	Në milionë lekë	Në përqindje
Kryeministria	3	179.1	15.1
Ministria e Ekonomise	1	19.0	1.6
Ministria e Bujqesise	2	244.0	20.6
Ministria e Financave	4	140.7	11.9
Ministria e Shendetesise	8	42.8	3.6
Ministria e Drejtesise	2	52.3	4.4
Ministria e Brendeshme	9	306.4	25.8
Instituti I Statistikave	1	39.2	3.3
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	1	55.4	4.7
Te tjera	8	107.8	9.0
Totali	39	1186.7	100.0

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit Maj 2010 janë realizuar pothuajse në nivelin e parashikimit të periudhës, ose në rreth 29.8 përqind të planit vjetor. Brënda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brëndshëm janë realizuar në masën 112.5 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 68.3 përqind të parashikimit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brëndshme rezultojnë rreth 12.0 miliardë lekë më të ulëta, ose rreth 36.6 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaja rezultojnë rreth 815 milionë lekë më të larta, ose rreth 20.2 përqind më shumë. Për rrjedhoje, investimet në total në fund të muajit Maj 2010 janë rreth 30.4 përqind më të ulëta, ose rreth 11.2 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës Janar - Maj 2010 është rreth 81.1 përqind nga financimi i brëndshëm dhe rreth 18.9 përqind nga financimi i huaj. Ecuria e investimeve kapitale me financim të brëndshëm dhe me financim të huaj gjatë pesëmuajve të parë në disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.

